



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 19.4.2023

Nr: 381

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**VERIFIKIMIN E TË DHËNAVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT, TË SUBJEKTIT  
VETËDEKLARUES Z. ERVIN MUHARREM MUHARREMI, KANDIDAT PËR ANËTAR NË KËSHILLIN  
BASHKIAK, I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA KONSERVATORE", PËR BASHKINË**

**KLOS**

Sot më datë 19.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

**OBJEKT:** Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Ervin Muharrem Muharremi, kandidat për anëtar në këshillin bashkiak, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Konservatore", për Bashkinë Klos.

**BAZA LIGJORE:** Neni 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenet 5 dhe 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut II, III, V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

**V Ë R E J:**

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për

Data: 19.4.2023 Nr: 381  
Ora: 12:00



"Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Ervin Muharrem Muharremi, kandidat për anëtar në këshillin bashkiak, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Konservatore", për Bashkinë Klos".

administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe kandidati për kryetar bashkie apo anëtarë në këshillat bashkiak.

Me vendim të KZAZ-së, z. Ervin Muharrem Muharremi, është regjistruar si kandidat për anëtar në këshillin bashkiak, propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Konservatore", për Bashkinë Klos.

Për këtë kandidat, në datën 1.4.2023, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është depozituar formulari e vetëdeklarimit, i cili është regjistruar me nr. unik DI-KONS -16430. Në kuadër të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit të këtij kandidati, sipas përcaktimit të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Në përgjigje të kësaj kërkesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve informon se kandidati në fjalë nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Ervin Muharrem Muharremi, rezulton:

- Në rubrikën I. "TË DHËNA PERSONALE", PIKA B, "Gjeneralitete të mëparshme" të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues nuk ka deklaruar se ka ndryshim tek gjeneralitetet e tij.
- Në rubrikën III. "TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT", të Formularit të Vetëdeklarimit, pyetjes 7 "A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj?", subjekti i vetëdeklarimit është përgjigjur "PO", është marrë masa e dëbimit nga shteti Gjerman, në vitin 2016, për arsye dokumentacioni.
- Pyetjes 8 "A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?", subjekti i vetëdeklarimit është përgjigjur "PO", ka jetuar në Gjermani për 2 vite, për arsye emigracioni.

Në vlerësim të përmbajtjes së deklarimeve si më sipër në formular, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve çmon se është e nevojshme marrja e informacioneve shtesë, në lidhje me faktet që lidhen me autoritete dhe vende të huaja. Në nenin 2, pika 2, të ligjit nr.138/2015, përcaktohet se për veprat penale të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nuk ka kompetencën për të kryer verifikime.

Në mbështetje të nenit 8, pika 1, të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreu V, pika 3, shkronja "b/ii)", të Vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, është Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit, që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

## V E N D O S:

1. Kryerjen e verifikimit të thelluar të subjektit vetëdeklarues z. Ervin Muharrem Muharremi, kandidat për anëtar në Këshillin Bashkiak, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Konservatore” për Bashkinë Klos, dhe dërgimin e të dhënave përkatëse Prokurorisë së Përgjithshme për vlerësim të mëtejshëm.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**